## Programi i Zhvillimit të Kapaciteteve RCDN për Kanalizimet dhe Ujërat e Ndotur

## KURRIKULA

### 1B "Hyrje në Sistemet e Kanalizimeve dhe Trajtimit të Ujërave të Ndotur për Menaxherët dhe Inxhinierët"

<table>
<tr><td colspan="4">Kurrikula për"Hyrje në Sistemet e Kanalizimeve dhe Ujërave të Ndotur për Menaxherët dhe Inxhinierët"</td></tr>
<tr><td colspan="4">Objektivi i përgjithshëm i programit: Pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të marrin një rol aktiv gjatë planifikimit dhe zbatimit të infrastrukturës së kanalizimeve dhe trajtimit të ujërave të ndotur.</td></tr>
<tr><td>Grupi i synuar: Niveli strategjik</td><td>• <u>Menaxherët dhe stafi teknik i shoqërive UK, duke zbatuar ose drejtuar sistemet e kanalizimeve dhe trajtimit të ujërave të ndotur</u>:<br>(1) Menaxher Teknik; (2) Anëtarët e NJZP-ve; (3) Stafi teknik;<br>Sekondarë: (4) Stafi i Laboratorëve (5) Departamenti për Marrëdhëniet me Klientët [3]<br><br>• <u>Stafi i bashkisë</u> :<br>(1) Departamenti i Çështjeve Komunale, (2) Departamenti i Investimeve, (3) Zyra e Kryetarit</td><td>Kohëzgjatja 1</td><td>Kohëzgjatja e përgjithshme fleksibël, deri në 6 muaj<br>Moduli 1: 2 Ditë<br>• Trajnimi 1: Aspektet Rregullatore Ligjore, Institucionale dhe të Financimit.<br>Moduli 2: 3 Ditë<br>• Trajnimi 2: Teknologjitë (3 Ditë)<br>Moduli 3: 3 Ditë<br>• Trajnimi 3: Aspektet e Menaxhimit të Projekteve Infrastrukturore (2 ditë)<br>• Shkëmbime/diskutime mes kolegëve 1: Projektet Infrastrukturore (1 ditë)</td></tr>
<tr><td>Objektivat specifike të mësimit t</td><td>• Pjesëmarrësit janë në gjendje të shpjegojnë statusin e sektorit të kanalizimeve dhe trajtimit të ujërave të ndotura dhe kuadrin ligjor dhe institucional në nivel kombëtar dhe NJQV.<br>• Pjesëmarrësit janë në gjendje të shpjegojnë sisteme të ndryshme të grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotur, duke u fokusuar tek aspektet teknike dhe të shpjegojnë rëndësinë e tyre.</td><td>Temat kryesore 2</td><td>Moduli 1: Aspektet Rregullatore dhe të Financimit (Trajnimi 1)<br>• Vështrim i shkurtër i çështjeve të administrimit duke përfshirë statusin e sektorit në rajon/në vend:<br>o Mbulimi me shërbimin e kanalizimeve,<br>o Mbulimi me shërbimin e trajtimit të ujërave të ndotur,<br>o Strategjitë ekzistuese në nivel kombëtar,<br>o Legjislacionet (në krahasim me kërkesat e BE-së),<br>o Strategjitë ekzistuese në nivel bashkie, p.sh. masterplanet.</td></tr>
</table>

| | | | |
|---|---|---|---|
| Objektivat specifike të mësimit të moduleve | • Pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të kuptojnë elementë kryesor të menaxhimit të një projekti infrastrukturor të kanalizimeve dhe trajtimit të ujërave të ndotur. | | • Konteksti ligjor dhe administrativ,<br>• Rregulloret dhe standardet,<br>• Aktorët në sektorin e kanalizimeve dhe trajtimit të ujërave të ndotur,<br>• Menaxhimi Financiar,<br>• Tarifimi (mbledhja dhe trajtimi i ujërave të ndotura),<br>• Marrëdhëniet me konsumatorët - Ndërgjegjësimi i klientëve për nevojat dhe përfitimet nga grumbullimi dhe trajtimi i ujërave të ndotura.<br><br>**Moduli 2: Teknologjitë (Trajnimi 2)**<br>• Llojet e sistemeve të kanalizimeve dhe të trajtimit të ujërave të ndotur (KUN) (të përziera, të ndara ...) (vlerësim teknik).<br>• Sistemet e decentralizuara kundrejt atyre të centralizuara.<br>• Sistemet e KUN (përzgjedhja e terrenit të ITUN, Dimensionimi, sistemet e grumbullimit dhe trajtimit - tubacionet dhe strukturat, asgjësimi dhe/ose ripërdorimi i llumit, funksionimi dhe mirëmbajtja, kërkesat për energji, cilësia e rrjedhjeve, çështjet mjedisore).<br>• Menaxhimi i integruar i burimeve ujore IWRM, Menaxhimi i integruar i ujit urban IWUM, Menaxhimi i ujërave të reshjeve me bazë natyrën.<br><br>**Moduli 3: Aspektet e Menaxhimit të Projektit (trajnimi 3) Shkëmbimet/diskutimet mes kolegëve (1 ditë)**<br>• Cikli i Projektit për Projektet e Infrastrukturës së Kanalizimeve dhe Trajtimit të Ujërave të Ndotur (Hyrje),<br>• Studimi i Fizibilitetit,<br>• Zhvillimi i planit të Bashkisë për menaxhimin e kanalizimeve dhe ujërave të ndotur/Master Plani/Procesi i planifikimit, fazat, plani i investimeve prioritare, kostot e ciklit të jetës duke përfshirë kostot operacionale dhe amortizimin.<br>• *Shënim: Theksi është më shumë tek pjesa* |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | | *dhe temat më teknike, pasi grupi i synuar është në ndërveprim të drejtpërdrejtë me konsulentët dhe duhet të jetë në gjendje të marrë vendime të informuara.* |
| Formati: | • Deri në 3 module për rritjen e kapaciteteve (trajnim dhe shkëmbim kolegësh) plus elementë bashkëpunues (p.sh. punë ndërvepruese në grup)<br><br>Mundësi të tjera:<br>• Uebinar përgatitor para aktivitetit ballë për ballë për të përgatitur pjesëmarrësit dhe për t'iu përgjigjur kolektivisht pyetjeve gjatë aktivitetit.<br>• Përdorimi i platformës të internetit ose platformave të ngjashme virtuale (p.sh. Facebook, Viber, WhatsApp) për të qëndruar në kontakt më vonë.<br>• Zhvillimi i një grupi Pyetje -Përgjigjesh dhe përgatitja e Pyetjeve më të Shpeshta (FAQ). | Aspektet metodologjike: | • Kontributi i përshtatur sipas pjesëmarrësve dhe ndërtimi së bashku në grup për të lehtësuar transferimin dhe zbatimin e njohurive mbi temën e zgjedhur:<br>o Të **dhëna të përshtatura** sipas ekspertëve/personave teknik, përshtatja e kontekstit kombëtar dhe bazuar në temën e zgjedhur - e shkurtër, por gjithëpërfshirëse.<br>o **Shkëmbimi/diskutimi mes kolegësh** dhe ndarja dhe reflektimi i përvojave për të nxitur të mësuarin e pjesëmarrësve nga njëri –tjetri.<br>o **Shkëmbim formal dhe i strukturuar** në platformën në internet.<br>o **Punë ndërvepruese në grup** për të reflektuar dhe për të aplikuar njohuritë e mësuara, p.sh<br>- Konferencë online,<br>Webinar me një temë "të nxehtë".<br>Ujërat e Ndotur |
| Materiali: | • Mjete vizualizimi (p.sh. tabela ku mund të vendosen shënime, tabela magnetike, flipçarte)<br>• Manualët,<br>• Prezantimet në Power Point, dhe<br>• Materialet për t'u shpërndarë gjatë trajnimit (përshkrimi i praktikave të mira/rastet e studimit, broshura, videoklipe), formularë shabllon dhe lista kontrolli,<br>• Udhëzime për shoqërim/ bashkëpunim në internet, mundësi transferimi,<br>• Opsionale: Kartat mësimore për Hapat e | Profili i trajnerit/ moderatorit: | • Përvojë në zhvillimin e kapaciteteve<br>• Përvojë në lehtësimin/moderimin e formateve të ndryshme të rritjes së kapaciteteve.<br>• Njohuri të thella dhe të gjera teknike të sistemeve të ujërave të ndotur dhe teknologjive të trajtimit.<br>• Njohuri të thella për sfidat e zakonshme të NJQV-ve dhe/ose shoqërive UK që lidhen me grumbullimin dhe trajtimin e ujit te ndotur.<br>• Njohuri të thella për mjedisin e punës të shoqërive UK dhe/ose lidhjet e tij me qeverinë vendore.<br>• Pjesëmarrja në kursin specifik të ToT.<br>• Njohuri të thella të qasjes metodologjike të RCDN dhe Standardeve të Cilësisë. |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | ITUN. | | |
| Rezultati: | • Përmbledhja e materialeve (axhenda, materialet për t'u shpërndarë gjatë trajnimit, informacione mbi kontekstin),<br>• Krijimi i një grupi pjesëmarrësish në një situatë të ngjashme (opsionale, në varësi të vendimit të pjesëmarrësve)<br>• Raporti dhe dokumentimi me fotografi.<br><br>Opsionale:<br>• Uebinare hyrëse dhe uebinare të tjera ,<br>• Platforma e internetit post-kurrikulum ose platformë e ngjashme për shkëmbime të vazhdueshme mes grupit. | Përgatitja: | • Vlerësimi i pjesëmarrësve në trajnim,<br>• Përgatitja e bazuar në vlerësim - kryerja e vlerësimit para çdo cikli trajnimi,<br>• Përgatitja e sesioneve (përzgjedhja dhe përshkrimi i praktikave të mira, dizajni dhe materialet e sesioneve, rastet studimore), p.sh. për shkëmbimin mes kolegësh dhe bashkëpunimin në internet,<br>• Krijimi i një platforme online për elementët bashkëpunues midis dy sesioneve dhe regjistrimi i pjesëmarrësve në të,<br>• Përdorimi i udhëzimeve për bashkëpunimin në internet për të zhvilluar materiale specifike për kontekstin dhe pyetje për mundësitë e ritransferimit dhe për elemente të tjera shoqëruese. |
| Përfitime të mundshme shtesë për pjesëmarrësit | • Kanale të shpejta komunikimi të bazuara në mediat sociale moderne (p.sh. grupe WhatsApp, etj.) me kolegë nga shoqëri të tjera UK.<br>• Rritja e aftësisë negociuese (p.sh. me menaxherët e lartë).<br>• Të pasurit e një pozicioni të mirë për të këshilluar menaxherët e lartë për çështjet teknike, qoftë në fazën e planifikimit, qoftë në atë të funksionimit dhe mirëmbajtjes. | | |

*Datë: 20.04.2022*